

RELACION

Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e parë të vitit 2012

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr. Nr. 10 487, dhe datë 5.12.2011 "Per buxhetin e shtetit për vitin 2011", Udhezimit nr. 2 datë 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetin"

dhe Udhezimit nr.2/1 datë 15.02.2012 "Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2012", i është akorduar një fond i planifikuar prej **94 milione e 792 mijë lekë**, i cili përbehet nga:

Fondi i Pagave:	11,089,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	1,703,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	7,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	73,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	2,000,000 Lekë (zeri 231)

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në **34,916,661 leke** nga totali prej **94.792.000 Leke** ose **36.8%**, të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE".

Gjatë 3- mujorit të dytë të vitit 2011, numri mesatar i punonjësve është realizuar 13 vete, nga 12 vete të miratuar.

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

2, 305, 281 Lekë (zeri 600) për paga, realizimi **20.7%**.

272,944 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqerore, realizimi **16%**.

Fondi per shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602), për vitin 2011, është planifikuar në vlerën 7,000,000 leke. Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **238, 436 Lekë** ose **3.4%** e planit vjetor.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike falas për publikun, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.

- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevojat e AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.

- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të treta, të mbartura nga 2011.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2012 është planifikuar në vlerën 73,000,000 leke. Ky është dhe zëri me më shumë në strukturën e buxhetit të AMSHC, duke qenë se dhe vetë misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet të OJF përfituese.

Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **32,100,000 Lekë** ose **43.97%**, e planit vjetor.

Në realizimin e këtij zëri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet për këstin e parë (50%) e thirrjes së tretë, me pjesën e dytë (40%) dhe të tretë (10%) të Granteve të miratuara dhe të kontraktuara në vitin 2010 dhe 2011, për Organizatat Jo-Qeveritare përfituese të financimit me Grante.

Fondi për shpenzim investim (zëri 231) ,

2,000,000 Lekë (zëri 231) për Investime të Trupezuara, realizimi **0%**.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile", si dhe legjislacionin administrativ-financiar shqiptar.

Drejtor Ekzekutiv

RUDI BOBRATI